

SA JANË QYTETET TONA GJITHËPËRFSHIRËSE?

© Davide Bonazzi

Kosova pas lufte u ballafaqua me një kaos të vërtetë në aspektin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të qyteteve tona. Urbanizimi i shpejtë, lëvizja nga fshatrat e qytetet e vogla kah qendrat më të mëdha në kërkim të kushteve më të mira për jetë, punë e shkollim rezultoi me zgjerimin e pakontrolluar të qyteteve. Autoritetet qendrore dhe lokale u gjendën të papërgatitura të përballojnë këtë trend të urbanizimit. Migrimi u manifestua me rritjen e popullatës urbane, zgjerim të qyteteve që u përçjell më tutje me zvogëlimin e tokave bujqësore, mungesë të infrastrukturës, shërbimeve sociale dhe probleme mjedisore.

EC Ma Ndryshe gjatë verës 2021 ka kryer një hulumtim me qytetarë ku është tentuar të mirren përshtypjet, perceptimet dhe sfidat e qytetarëve sa i përket funksionimit të qyteteve ku ata jetojnë si dhe të mësojë se sa qytetarët e Kosovës kanë qenë të përfshirë në procese të ndryshme të hartimit të planeve urbane të qyteteve të tyre. Pra, thjesht dëshirojmë të dijmë se sa janë qytetet tona gjithëpërfshirëse?

Pyetësori ka qenë anonim dhe ka mostër me afërsisht 350 respondentë të përgjigjur. Pjesëmarrësit dominant në hulumtim kanë qenë nga qytetet e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejë duke mos përfshirë asnjë qytet tjetër.

Raporti M/F ka qenë 41/59% përderisa moshat më dominante kanë qenë 19-30 vjet (67%) dhe 31-50 vjet (24%).

Ky aktivitet përkrahët nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

KCSF
KOSOVAN CIVIL SOCIETY FOUNDATION
KOSOVAN CIVIL SOCIETY FOUNDATION

Shtator 2021

KUALITETI I HAPËSIRAVE TË QYTETEVE TONA

58%



Më shumë se gjysma e qytetarëve mendojnë se ka hapësira të mjaftueshme për banim në qytetet, gjegjësisht komunat e tyre. Ky është edhe tregues i qartë se dekadave të fundit kemi një bum të madh të ndërtimeve shumëbanesore dhe atë me çmime nga më të volitshme e deri tek ato më luksoze.

24%



Vetëm 24 përqind të respondentëve kanë opinionin se qyteti, gjegjësisht vendbanimi i tyre ofron alternativa të mjaftueshme për punësim. Kjo pasqyron edhe gjedjen reale të mungesës së vendeve të punës në nivel vendi.

75%



Shumica dërmuese e respondentëve mendojnë se qyteti i tyre nuk ka gjelbërime të mjaftueshme.

72%



Shumica dërmuese e qytetarëve të intervistuar shprehen se transporti publik në qytetin e tyre nuk është i organizuar mirë apo edhe nuk ekziston fare.

75%



Shumica dërmuese e qytetarëve mendojnë se ka mungesë të hapësirave publike në qytetet dhe fshatërat e tyre. Në raste kur edhe ekzistojnë hapësirat publike ato shpesh janë të pamirëmbajtura nga autoritetet komunale apo edhe të uzurpuara nga shfrytëzues të paautorizuar.

77%



Për më tepër, shumica shprehen se nuk ka hapësira publike të mjaftueshme për sport, rekreim dhe kulturë. Ato kryesisht janë me pagesë duke krijuar kështu diskriminim për qytetarë.

85%



Diskriminimi vërehet edhe më tepër tek grupet e ndryshme të shoqërisë (të moshuarit, prindër me karroka, persona me aftësi të kufizuara, etj) për të cilët nuk ofrohen hapësira (rrugë, parqe, etj) të sigurt. Tek këto hapësira ka mungesë të ndriçimit publik dhe pjerrina të përshtatshme.

PROBLEMET DHE SFIDAT TJERA TË IDENTIFIKUARA NË QYTETE E KOMUNA:

- Qendë endacakë
- Papastërtia dhe mbeturinat e pagrumbulluara
- Trafiku i stërngarkuar
- Bllokimi i trotuarave nga veturat
- Pasiguria e prindërve që fëmijët të shkojnë në shkollë në mënyrë të pavarur
- Rritja e përkrahjes së zonave të banimit pa infrastrukturë përcjellëse
- Mungesa e parqeve (hapësirave gjelbëruese) nëpër lagje të qyteteve
- Mungesa e qendrave rinore për aktivitetet kulturore e rekreative/sportive
- Zona banimi të mjaftueshme por me kualitet të dobët të jetës
- Pasiguria e rrugëve gjatë orëve të mbrëmjes për gra, vajza e fëmijë
- Ndotja nga ndërtimet e reja dhe trafiku i ngarkuar
- Mungesa e parkingjeve publike
- Mungesa e vetëdijes qytetare për mirëmbajtje të hapësirave publike

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

83%



Pjesa dërmuese e qytetarëve vetëm kanë dëgjuar apo kanë njohuri të kufizuara për Planet Zhvillimore Komunale, Planet Zhvillimore Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane të qyteteve gjegjësisht komunave të tyre. Pjesa tjetër (17%) nuk kanë njohuri fare për këto dokument të planifikimit hapësinor.

10%



Vetëm një grup shumë i vogël i qytetarëve janë përgjigjur me PO në pyetjen nëse janë ftuar ndonjëherë në ndonjë proces të hartimit të këtyre planeve hapësinore në komunën e tyre.

90%



Qytetarët e ftuar apo të inkuadruar në proceset e planifikimit në qytetet e tyre në mënyrë dominante pretendojnë se kërkesat, sugjerimet apo vërejtjet e tyre nuk janë marrë parasysh.

QYTETARËT THEKSOJNË SE PLANET ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE URBANE TË DERITASHME:

39%

Kanë ndikuar në degradim të mëtutjeshëm të qytetit / komunës së tyre

38%

Kanë ndikuar për të mirë por ka ende shumë sfida të patrajtuara

19%

Nuk kanë mendim / Nuk e dijnë

4%

Kanë ndikuar që qyteti / komuna të ketë zhvillim më të mirë hapësinor

62%



Hartat Zonale të Komunave (HZK) janë dokumentet e reja të planifikimit hapësinor të cilat do të hartohen për komunat e Kosovës pas ndryshimit të Ligjit të Planifikimit Hapësinor në vitin 2013. Më shumë se gjysma e respondentëve nuk kanë fare njohuri ose vetëm kanë dëgjuar për këto dokumente.

90%



Shumica dërmuese e të anketuarve mendojnë se institucionet lokale e qendrore nuk i kanë njohitur mjaftueshëm për procesin e Hartës Zonale të Komunës (HZK) respektive.

95%



Shumica dërmuese e të anketuarve theksojnë se komuna e tyre nuk i ka ftuar në takime që kanë të bëjnë me proces të hartimit dhe konsultimit të Hartës Zonale të komunës respektive.

A MENDOJNË QYTETARËT SE HARTAT ZONALE DO TË ADRESOJNË ÇËSHTJET QË I BREGNOSIN DHE DO TË PËRMIRËSOJNË GJENDJEN E QYTETEVE TONA?:

59%

Nuk janë të sigurtë

28%

Po

13%

Jo

LIGJET DHE INSTITUCIONET

59%



Më shumë se gjysma e respondentëve që janë përgjigjur në hulumtim janë shprehur se nuk kanë njohuri për ligjet që rregullojnë planifikimin hapësinor në vendin tonë.

94%



Shumica dominuese e respondentëve mendojnë se ligjet për planifikim hapësinor në Kosovë nuk zbatohen mjaftueshëm.

72%



Ligji për planifikim hapësinor në Kosovë për herë të parë është aprovuar në vitin 2003 përderisa në vitin 2013 është miratuar ligji i ri duke vazhduar në vitet në vijim me Udhëzimet Administrative për Zbatim të po këtij ligji. 72% e qytetarëve nuk kanë njohuri rreth ndryshimeve që ka pësuar ky ligj.

QYTETARËT MENDOJNË SE PROBLEMET KRYESORE TË ZBATIMIT TË LIGJEVE NË KËTË LËMI JANË:

- Korrupsioni dhe nepotizmi në dhënie të lejeve ndërtime
- Moszbatimi i ligjeve në fuqi për planifikim
- Ndërtime pa kritere që shkatërrojnë zonat me gjelbërime
- Menaxhimi jo-efikas i mbeturinave
- Rritja e qyteteve në mënyrë të pakontrolluar për zona të reja banimi pa infrastrukturë përcjellëse
- Mungesa e inspektimit (inspektorëve) në monitorim të zbatimit të lejeve ndërtime të lëshuara
- Interesi privat i investitorëve (nga sektori i ndërtimit) gjithmonë dominon interesin publik të komunitetit më të gjërë
- Mungesa e vetëdijes tek qytetarët për rëndësinë e planeve urbane
- Ndikimi politik në fushën e planifikimit hapësinor
- Mosefikasiteti i gjykatave në trajtim të lëndëve që degradojnë qytetet tona
- Për plane urbane organizohen konsultime publike formale «vetëm sa për sy e faqe» dhe për të plotësuar kërkesat ligjore
- Edhe kur planet hapësinore janë profesionale, ato nuk kanë mekanizëm monitorues për zbatueshmëri të tyre

SA MENDONI QË INSTITUCIONET DHE LIGJET TONA I KANË KUSHTUAR RËNDËSI ZBATIMIT TË TEMAVE TË MËPOSHTME:

PAK

MESATARISHT

SHUMË

1. Mbrojtjen e mjedisit dhe kualitetit të ajrit

70%

29%

1%

2. Krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimit ekonomik

66%

32%

2%

3. Kërkesave për banim të përballueshëm

50%

39%

11%

4. Kualitetin dhe gjithëpërfshirjen e hapësirave publike

59%

38%

3%

5. Kujdesin ndaj grupeve të cenueshme të shoqërisë (të moshuarit, të sëmurët, personat me aftësi të kufizuara, LGBTI+, emigrantët, etj)

79%

19%

2%

6. Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

51%

43%

6%

7. Transportin dhe lëvizshmërinë e përshtatshme nëpër qytet

49%

42%

9%

8. Ofrimin e digjitalizimit në shërbime publike

42%

48%

10%